



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.494/21

Datë: 27.09.2021

Duke u bazuar në Ligjin Nr.02/L-52 Mbi Edukimin Parashkollor ,Udhëzimit Administrativ Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, Drejtori i Drejtoris Komunale të Arsimit në Istog ,shpall këtë:

KONKURS PLOTËSUES PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOMUNËN E ISTOGUT PËR VITIN 2021/22

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog shpall konkurs për këto vende të lira në institucionet parashkollore publike në Komunën e Istogut

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2021-2022

Grup-mosha	IP. Gzimi Ynë Istog	IP.Pëllumbat e Ardhmërisë Rakosh	IP. Lulet e Jetës Vrellë	IP. Ardhmëria Jonë Gurrakoc	IP. Shpresa Jonë Banië	Gjithsej
09 -> 2 vjet.				2		2
2-> 3 vjet.						
3-> 4 vjet.						
4-> 5 vjet.				5		5
5->6 vjet						
3->6						
Gjithsej				7		7

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 28.09.2021,deri me 05.10.2021.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve behet në Institucionet parashkollore përkatëse çdo ditë punë prej orës 09:00 deri në ora 15:00

Shpallja e rezultateve behet me datën **11.10.2021** në Institucionet parashkollore përkatëse si dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Istogut,

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionet parashkollore bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë dhe Rregulloreve Komunale.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në Institucionin parashkollor përkatës (aty ku ka aplikuar) dhe nëse serish janë të pakënaqur me vendimin e institucionit, atëherë mund të ushtrojnë ankesë në DKA.

Drejtoria Komunale e Arsimit nuk do ti shqyrtoj asnjë ankesë nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim në ankesën e ushtruar në komisionin e Institucionit parashkollor përkatës.

Vrejtje: evidenca e dokumenteve të cilat kërkohen që ti bashkëngjiten aplikacionit për aplikim gjenden të përshkruara në aplikacion.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opshtina Istok
Municipality of Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), si dhe bazuar në ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32), Udhëzimit Administrativ Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë dhe me qëllim të mënjanimit të subjektivizmit, joprofesionalizmit dhe familjarizmit me rastin e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore (IP) publike të Komunës së Istogut, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit merr këtë:

VENDIM

PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Istogut mundë të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP), të Komunës së Istogut.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve.
3. Moshë minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP e përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e regjitrimit por datën e fillimit të shërbimit.
4. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

№	Kategoria	Valë
1	Fëmijët me nevojë të veçantë të aftësisë	100
2	Fëmijët boujakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
		80
4	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
12	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	15
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	10
15	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	40
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	30
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	25
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve mbi 1000 euro)	20
19	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen – Bashkësinë Lokale ku gjendet IP-ja	20
20	Fëmijët e punëtorëve të IP-ve	10
21	Fëmijët e prindërve që tashmë e kanë një fëmijë vijues në IP	10
22	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit deri në 350 euro)	20
23	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 351 - 700 euro)	15
24	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 701 - 1000 euro)	10
25	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit mbi 1000 euro)	5

5. Të gjitha statutet e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante.

6 Ky vendim hynë në fuqi me një here

7.Për zbatimin e ketij vendimi obligohen IP ,Komisioni perzgjedhes dhe nje kopje në arkivin e këtij institucioni.

